



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF
GJAKOVA



DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

**THIRRJE PËR APLIKIM
(Ri-shpallje)**

Përkrahje me

1. Set për nevoja të bletarëve (14 cope),

(Subvencione ne kuadër te sektorit te Bletarisë)

Gjakovë, Qershor 2025

Në bazë të nenit 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, si dhe nenin 10 dhe 14 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës me Nr. 01/110-01-3560 të datës 04.02.2020, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (DBPZHR) :

Njofton bletaret e Komunës së Gjakovës, që mund të aplikojnë për skemën e subvencioneve të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për mbështetjen e tyre me:

- **Set për nevoja te bletarit** (vaske për nxjerrje te mjaltës depozitues mjalti 50kg, tymuese, doreza për bletare, kapëse dhe çelës për hapje te kornizave, brusha druri, bluza dhe kapele, site me dy shtresa dhe pirun për zhvulosjen e kornizave)

Kriteret e pranueshmërisë :

- Ndarja proporcionale sipas rajoneve – pesë (5) rajone;
- Fermeret femra, minoritetet dhe të rinjtë kanë përparësi;
- Përfituesit duhet të bashkë financojnë vlerën e subvencionit minimum 20%;
- Aplikuesit të mos jenë përfitues te Subvencioneve nga Komuna nga viti paraprak dhe viti aktual;
- Përparësi kane bletaret qe nuk kane përfituar gjate viteve te fundit;
- Aplikuesi duhet të jetë banor i Komunës së Gjakovës;
- Te jete aplikues ne Pagesa Direkte ne kuadër te MBPZHR-se (për vitin 2025);
- Aplikuesit duhet te kenë te shënuar ne çdo koshere ne bletishten e tyre numrin identifikues te fermerit - NIF sipas standardit;
- Aplikuesit për pajisje te bletarisë duhet të kenë së paku 30 koshere bletësh te aplikuar ne Pagesa Direkte ne kuader te MBPZHR-se (për vitin 2025);

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Numri identifikues i fermerit (NIF - kopje);
- Vërtetimi i tatimit në pronë;
- Dëshmia e Aplikimit ne Pagesa Direkte 2025 (Formulari i Aplikimit);
- Deklarata ne betim.

Fletë aplikacioni tërhiqet në zyrat e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (DBPZHR) të Komunës së Gjakovës.

Afati i aplikimit: **13.06.2025 deri me 20.06.2025**